



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:063948
Datë: 18.10.2023
Numri i dokumentit: 04812945

C.nr.4407/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rezarta Sylejmani Voca, në çështjen kontestimore të paditësit G.. Sh.. nga P.., me adresë të banimit rr: V.. Sh.., nr.2..., KK P.., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit V.. Z.. avokat nga P.., kundër te paditurës P.. e K.., me seli në P.. rr.”L.. H.. p.n”, të cilën e përfaqëson nga Avokatura Shtetërore e Kosovës, me objekt të padisë anulimit të vendimit (kontest pune), pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor në prezencën e të autorizuarit të palës paditëse e në mungesë të autorizuarit të palës së paditur me datën 02.10.2023, më datën 18.10.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit G.. Sh.. nga P.. ashtu që **ANULOHET** vendimi i të paditurës -Komisionit për Ankesa në P.. së K.. me numër të lëndës 191-KA-2021, i datës 01.03.2021, me të cilën paditësit i është shqiptuar ndalesë në pagë 10% për dy muaj nga paga bruto, si **i kundërligjshëm**.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndëgjyqëse

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi në gjykatë më datën 06.04.2021, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës, dhe atë Vendimit te Komisionit te Ankesave të P.. së K.., me shenjen 191-KA-2021 të datës 01.03.2021. Ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura në pozitën e punës si Udhëheqës i Ekipit të Inteligjencës për Rajonin e P.. në kuadër të Drejtorisë për Inteligjencë dhe Analizë të cilën e mbanë nga data 26.02.2015. Ka theksuar se me datë 05.05.2020 vartësi i tij, zyrtari p.. P.. T.. kishte dërguar një kërkesë për regjistrim në sistemin PRIMs të P.. së K.. të disa orëve me kompensim dhe kishte bashkangjitur dy forma, njëra për Rreshter U.. G.. e tjetra për vet P.. T.., ku orët për të cilat kishte kërkuar kompensim ishin në kundërshtim me Procedurën Standarde të Operimit (PSO) për punë jashtë orari dhe Udhëzimin Administrativ (UA) mbi marrëdhënien e punës. Ka theksuar se më datën 06.05.2020, kur nuk ka qenë në punë, mbikëqyrësi i tij Major N.. C.., në kundërshtim me rregullativën e përmendu ka kërkuar nga ai që deri në fund të orarit ti regjistroj orët me

kompensim për vartësit e lartpërmendur, ku njeherit, pa kërkesën e tij, në emër të tij, kishte regjistruar dy ditë nga 12 orë edhe për te. Pavarësisht kësaj, Major N.. C.. pas 17 minutave e kishte caktuar rreshter U.. G.. si zëvendësues të tij, i cili të njëjtën ditë i kishte regjistruar orët edhe pse e ka ditur se ky regjistrim nuk ka qenë i lejuar. Tutje ka theksuar se me datën 07.05.2020 Major N.. C.. ia ka përcjellë shkresën e dërguar nga Kolonel H.. P., me kërkesë rishikimin dhe përmirësimin e orëve shtesë në sistemin PRIMIS deri me date 08.05.2020 ora 12:00 dhe atë për periudhën kohore nga data 25.03.2020 deri më datë 30.04.2020 pasi disa mbikëqyrës, kishin regjistruar ore shtesë pa u plotësuar kriteret dhe në kundërshtim me PSO-07DP- 19 për angazhim të punonjësve jashtë orarit të rregullte të punës si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në P.. e K.. Ka theksuar se me datën 08.05.2020, ka qenë në detyrë në ndërrimin e paradites dhe duke vepruar sipas kërkesës se eprorit, rreth orës 11:00 i ka shlyer orët shtesë të cilat u ishin regjistruar vartësve të tij për periudhën kohore të kërkuar. Lidhur me veprimet e ndërmarra e ka njoftuar Major N.. C.. me email dhe njëherit ka kërkuar nga ai ti fshij nga sistemi edhe orët të cilat i njëjti i kishte regjistruar për të, mirëpo Major N.. C.. nuk ka vepruar sipas kërkesës së tij.

Me date 13.05.2020 ka deklaruar se ndaj tij, Major N.. C.. kishte ngritur procedurë të brendshme disiplinore me arsyetimin e kryerjes së shkeljes disiplinore. Me date 17.12.2020 Komisioni i Brendshëm Disiplinor ka nxjerr vendimin me numër 359/KBD/20, me të cilën i ka shqiptuar masë :” Ndalesë në pagë 25% për dy muaj nga paga bruto, duke gjetur se është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 21, Mosbindje e rëndë pika 1.12. lidhur me piken 1.13 të UA Nr.04/2019.I pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka theksuar se ka ushtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, i cili ka aprovuar pjesërisht të bazuar ankesën duke ndryshuar vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor nga ndalesë në pagë 25% për dy muaj nga paga bruto në ndalesë në pagë 10% për dy muaj nga paga bruto.

Gjatë deklarimeve të dhëna në seancat gjyqësore, si dhe në fjalën përfundimtare, paditësi ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se paditësi ka ndërmarrë të gjithave veprimet e duhura konform ligjeve të aplikueshme, me kërkesë anulimin e vendimit të të paditurës si të kundërligjshëm dhe pa mbështetje ligjore.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi, ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar duke konsideruar se paditësi me asnjë provë materiale nuk i ka argumentuar pretendimet e parashtruara se e paditura ka vepruar kundërligjshëm me shqiptimin e masës disiplinore. Me propozim që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kurse Vendimi kontestues, anulimi i të cilit kërkohet të mbetet në fuqi

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata konform nenit 423.4 të LPK-së, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në mungesë të palës së paditur, të ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore.

Provat materiale të administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje kontestuese ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale; vendimi i komisionit të brendshëm disiplinor dt.24.12.2020, vendimi nr.prot.03/02-313 i datës 08.03.2021- Komisioni për ankesa i p.. së K.; parashtresa e datës 07.07.2023, njoftimi zyrtar për fillimin e hetimeve të brendshme i datës 12.06.2020, raporti përfundimtar i hetimeve nr.ref.0123-PK-2020 i datës 07.08.2020, raporti i përgjithshëm i hetimeve nr.ref. 0123-PK-2020 i datës 06.08.2020, komunikimi elektronik i datës 04.05.2020 në ora 11:40 dhe 14:37, komunikimi elektronik i datës 06.05.2020 në mes të N.. C.. dhe G.. Sh.. (ora 11:21 dhe 11:46), komunikimi elektronik i datës 05.05.2020 nga P.. T.. për paditësin, komunikimit elektronik, të datës 07.05.2020, komunikimi elektronik i datës 08.05.2020 nga paditësi për N.. C.., procesverbali i datës 03.07.2020 i intervistimit të N.. C.., procesverbali i datës 07.07.2020 i intervistimit të U.. G.., procesverbali i datës 07.07.2020 i intervistimit të P.. T.., procesverbali i datës 09.07.2020 i intervistimit të G.. Sh.., procesverbal mbi intervistën shtese datë 24.07.2020 i U.. G.., komunikimi elektronik nga PRIMIS i datës 06.05.2020, ora 14:40, 14:42, 14:45, komunikimi elektronik i datës 12.05.2020, nga P.. T.. për N.. C.., komunikimi elektronik i datës 08.05.2020, nga paditësi për N.. C.., komunikimi elektronik i datës 06.05.2020, nga H.. P.. ora 16:28, komunikimi elektronik i datës 04.06.2020, nga N.. C.. për paditësin dhe ai i datës 04.06.2020 nga paditësi për N.. C..

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi ka shërbyer punonjës në Policinë e Kosovës më detyrë Udhëheqës i Ekipit te Inteligjencës për Rajonin e Prishtinës në kuadër të Drejtorisë për Intelegjencë dhe Analizë, nga data 26.02.2015.

Po ashtu nuk ishte kontestuese, se organi i shkallës së parë për shkeljet e gjetura disiplinore, i ka shqiptuar masën disiplinore më ndalesë 25 % të pagës mujore bruto për 2 muaj, i cili vendim sipas organit të shkallës së dytë të të paditurës, është ndryshuar.

Në mes të palëve ndërgjyqëse si çështje kontestuese ishte çështja e ligjshmërisë së Vendimit të Komisionit për Ankesa i Policisë së Kosovës dhe vërtetimi nëse paditësi ka kryer shkeljet disiplinore për të cilat është ngarkuar.

Nga Raporti i përgjithshëm i hetimeve nr.0213-PK-2020, i përfunduar me datën 06.08.2020, gjykata gjeti se për rastin në hetim, janë intervistuar paditësi , i cili ka theksuar se po ti regjistronte orët shtesë do te vepronte ne kundërshtim me normativen e Policisë së Kosovës dhe do ta keqpërdorte detyrën. Kurse nga intervista e Major N.. C.., në cilësi të ankuesit, i njëjti kishte deklaruar përmes emalit e dërguar me datën 06.05.2020, ka kërkuar nga togeri Sh.., regjistrimin e orëve, kurse kërkesa e njëjtë është përcjellë edhe nga zyrtari policor P.. T.. më datën 05.05.2020. Kjo kërkesë nuk është përfillur nga togeri Sh.., ku më pas zëvendësimeve të lartcekura, janë regjistruar orët shtesë.

Në përmbledhje të raportit theksohet se pasi që toger Sh.. nuk i kishte regjistruar orët shtesë sipas urdhrorit të major C.., dhe më datën 06.05.2020 përmes sistemit PRIMIS, Reshter U.. G.. ishte caktuar si zëvendësues i togeri Shalës, ku i fundit nuk ka qenë përgjegjës për regjistrimin e orëve

shtesë për punonjësit reshter U.. G.. dhe P.. T.. , por me nënvlerësimin e urdhrave e Major N.. C.., ka shlyer orët e regjistruara dhe të nënshkruara nga majori C.. , të dy reshtereve-G.. dhe T...

Nga Raporti Përfundimtar i hetimeve me nr. ref.0213-PK-2020, të datës 07.08.2020, gjykata gjeti se janë zhvilluar hetimet disiplinore në drejtim të paditësit, me dyshime për shkelje disiplinore. Më datën 05.05.2020, polici P.. T.., i cili ka qenë në mbikëqyrjen e paditësit, ka parashtruar kërkesë të paditësi për regjistrimin e orëve shtesë, kurse me datën 06.05.2020, Majori N.. C.. kishte kërkuar nga paditësi toger G.. Sh.., si udhëheqës i njësisë Rajonale të Inteligjencës për Prishtinë, që ti regjistronte orët me kompensim për stafin në mbikëqyrjen e tij, deri e fund te orarit. Kurse më datën 08.05.2020, toger Sh.. e ishte njoftuar përmes emailit, Major N.. C.., se i kishte fshirë orët e regjistruara ditëve të fundit, pasi që Major C.. më datën 06.05.2020 kishte caktuar reshter U.. G.., zëvendësues të paditësit për ti regjistruar orët shtesë të P.. T.., kurse orët shtesë për reshter U.. G.. i kishte regjistruar Major C... Kurse me pas, pas dërgimit të emailit të datës 07.05.2020 e përcjellë nga ana e Major N.. C.., të pranuar nga Kolonel H.. P.., më datën 08.05.2020, togeri G.. Sh.. ka fshirë orët shtesë të regjistruara ditë më parë. Në fund të këtij raporti, është rekomanduar masa disiplinore Transfer disiplinor për paditësin.

Nga komunikimi elektronik i datës 06.05.2020, në mes të N.. C.. drejtuar paditësit G.. Sh.., vërtetohet se major C.. kishte kërkuar nga paditësi kompensimin e orëve shtese për reshterin U.. G.. dhe për zyrtarin P.. T.., deri në fund të orarit të punës. Kurse nga njoftimi i marrë nga PRIMIS, i datës 06.05.2020, drejtuar paditësit, vërtetohet se U.. G.. është caktuar si zëvendësues i G.. Sh.. nga data 06.05.2020 deri më 06.05.2020.

Nga komunikimi elektronik i datës 06.05.2020, i dërguar nga ana e Kolonel H.. P..,-Drejtor i Divizionit për Personel dhe administratë, vërtetohet se koloneli P.. ka njoftuar se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është përgjegjës që pas pranimit të dhënave nga punonjësi për numrin e orëve të punës jashtë orarit, ti regjistron ato në sistemin PRIMIS, duke mbetur në përgjegjësinë direkte të mbikëqyrësit që ti rishikoj dhe kontrolloj edhe njëherë regjistrimin e orëve me kompensim për zyrtaret që kanë qenë nën mbikëqyrje. Tutje thuhet se çdo regjistrim i orëve me kompensim monitorohet dhe tejkalmi i regjistrimit të orëve të punës që nuk është në pajtim me procedurën e paraparë paraqet shkelje disiplinore. Përmirësimet kërkohen të bëhen deri më datën 08.05.2020, ora 12:00.

Kurse sipas komunikimit elektronik, të datës 07.05.2020, nga UD Drejtori i i Departamentit për Shërbime Mbështetëse, H.. H.., titulluar si : “s qarim shtesë” është kërkuar nga ana e mbikëqyrësve rishikimi i regjistrimit të orëve shtesë për punë jashtë orarit duke përfshirë periudhën nga data 25.03.31.03.2020 si dhe 01.04-30.04.2020, duke evituar mundësinë të qenurit pjese e procedurave hetimore, me ç’rast ka kërkuar që ky sqarim ti përcillet secilit mbikëqyrës.

Nga komunikimi elektronik i datës 08.05.2020, në mes të paditësit drejtuar N.. C.., vërtetohet se paditësi ka njoftuar majorin C.. lidhur me orët e tepërta, të shlyera të cilat janë regjistruar ditëve të fundit dhe ka kërkuar fshirjen edhe të orëve të regjistruara në emër të tij.

Me leximin e Vendimit të date 17.12.2020, gjykata gjeti se Komisioni i Brendshëm Disiplinor i të paditurës, ka nxjerr vendim me numër 359/KBD/20, me te cilën paditësit i ka shqiptuar masë disiplinore:” *Ndalesë në pagë 25% për dy muaj nga paga bruto, duke gjetur se është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 21, pika 1.12. lidhur me piken 1.13 të UA Nr.04/2019 lidhur me nenin 43 të Ligjit për Policinë.*

I pakënaqur me vendimin e të paditurës, paditësi brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të P.. së K.., i cili ka aprovuar pjesërisht të bazuar ankesën duke ndryshuar vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor të paditurës, ashtu që në vend të ndalesës në pagë 25% për dy muaj, nga paga bruto, paditësit i është shqiptuar ndalesë në pagë 10% për dy muaj nga paga bruto. Komisioni i Ankesave, ne pjesën arsyetuese ka vlerësuar se në rastin konkret në lëndën ankimore nuk mund te vërtetohen akuzat nga Kreu III, neni 21- mosbindje e rëndë, pika 1.12 si dhe pika 1.13 të UA Nr.04/2019, për Shkeljet, Masat dhe Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës, kjo për faktin se nuk mund t'i vihet barre mos regjistrimi orëve me kompensim të kërkuara nga Major C.. me date 06.05.2020 për faktin në këtë ditë ka qenë në pushim.

Paneli i Komisionit për Ankesa konstatoi se fshirja e orëve me kompensim e kryer nga Toger Sh.. ndaj vartësve të tij me date 08.05.2020 edhe pse ishte kryer pas pranimit të shkresës zyrtare nga Major C.. më datën 07.05.2020, sipas emailit të Drejtorit të Divizionit për Personel dhe Administrate Kolonel H.. P.., si epror i nivelit më të lartë menaxhues, ky veprim ishte dashur të koordinohet me mbikëqyrësin e tij për faktin se i njëjti nuk i kishte regjistruar vet këto orë me kompensim në sistemin PRIMIS, dhe në rast se ka mëdyshje rreth orëve me kompensim të regjistruara, është dashur ti raportoj. Andaj, si rezultat i mosveprimit te paditësit ne këtë drejtim, komisioni kishte konstatuar se paditësi ka kryer shkelje të lehtë disiplinore nga Kreu III, neni 35- mosbindje e lehtë, pika 1.4. "Pa ndonjë arsye të veçantë shkelë udhëzimet administrative dhe procedurat e punës të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2019, për Shkeljet, Masat dhe Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës lidhur me nenin 43, të Ligjit për Policinë.

I pakënaqur me vendimin e Komisionit për Ankesa, paditësi i drejtohet gjykatës me padi. Pasi që vendimin e organit te shkallës së dytë, paditësi e pranuar me datën 10.03.2021, fakt ky i vërtetuar nga nënshkrimi i paditësit në vendimin e te paditurës në datën e njëjte, e që nuk është kontestuar nga e paditura, kurse padinë e ka parashtruar me datën 06.04.2021, gjykata ka konsideruar se padia e paditësit është e afatshme.

Vlerësime përfundimtar i Gjykatës

Gjykata gjeti se regjistrimi i orëve shtesë për vartësit e paditësit -P.. T.. dhe U.. G.., janë më datën 06.05.2020, në ditën kur paditësi nuk kishte qenë në punë, ashtu siç është konfirmuar edhe në vendimin e Komisionit për Ankesa, kurse sa i përket raportimit te orëve re regjistruara, paditësi nuk ka pasur ndonjë informatë për orët e regjistruara në mënyrë të kundërligjshme përpos orëve te tij e për te cilat kishte kërkuar çregjistrimin e tyre.

Nga te gjitha provat e administruara, gjykatës i rezultoi se paditësi ka vepruar konform kërkesave të datës 07.05.2020, të Kolonel H. P.,-Drejtor i Divizionit për Personel dhe administratë, pasi që paditësi ka qenë mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i punonjësve U. G. dhe P. T. dhe sipas Kolonelit P. përgjegjësia direkte bie tek mbikëqyrësi, që ti rishikoj dhe kontrolloj edhe njëherë regjistrimin e orëve me kompensim për zyrtaret të cilët i ka nën mbikëqyrje. Mënyra e regjistrimit të orëve shtesë parashihet edhe me Procedurat Standarde të Operimit, PSO-07DP-19 për angazhim të punonjësve jashtë orarit të rregullt të punës, ku në pikën VI, nën paragrafi 1.7, përcaktohet se kërkesa për kompensim për punë jashtë orarit behet të mbikëqyrësi i cili edhe e bënë regjistrimin e orëve të kompensimit për punë në sistemin PRIMIS lidhur me pikën VII, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt menaxhon oraret e punës.

Gjykata gjeti se rishikimi i regjistrimit të orëve shtesë për punë jashtë orarit duke përfshirë periudhën nga data 25.03.31.03.2020 si dhe 01.04-30.04.2020, dhe përgjegjësia nga ana e mbikëqyrësve lidhur me këtë, është përcaktuar edhe nga UD Drejtori i Departamentit për Shërbime Mbështetëse, H. H. përmes “sgarimit shtesë”. Shto kësaj faktin se paditësi ka qenë personi i cili ka pranuar emailin e Kolonel P., e jo zëvendësuesi U. G., ngase edhe sipas përcaktimeve nga 37 të UA Nr.04/2019, zëvendësuesi nuk i gëzon benefitet e pozitës të cilën e zëvendëson. Kurse Major N. C. nuk ka raportuar, arsyetuar apo argumentuar regjistrimin e orëve shtesë për U. G., por është mjaftuar vetëm për përcjelljen e emailit tek paditësi kurse me këtë veprim ka lënë të nënkuptohet se paditësi në pozitën e mbikëqyrësit përgjegjës, ka autorizime për vartësit e tij.

Me dispozitën e nenit 64, paragrafi 4, të Udhëzimit Administrativ NR.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, parashihet se është përgjegjësi e çdo mbikëqyrësi të mbajë evidenca për çdo punonjës që i ka nën mbikëqyrje, nder te tjera edhe për punët jashtë orarit. Për me tepër sipas këtij Udhëzim Administrativ nuk parashihet ndalesa që një zyrtar policor ta korrigjoj gabimin e një zyrtari policor tjetër ashtu siç nuk parashihet procedura e fshirjes së orëve dhe nëse ky veprim duhet të ndërmarrë në koordinim me mbikëqyrësin. Në këtë kuptim qëndron i pa bazuar dhe paargumentuar arsyetimi i dhënë në vendimin kontestues që parasheh fshirjen e orëve në koordinim me mbikëqyrësin.

Gjykata gjeti se me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Policinë, parashihet:” Zyrtari policor ka për detyrë t’i zbatoj urdhrat e ligjshëm të dhëna nga mbikëqyrësi” lidhur me paragrafin 2:” Zyrtari policor ka për detyrë t’i refuzoj urdhrat të cilët janë të paligjshëm dhe të raportoj për këtë menjëherë në pajtim me aktet nënligjore”. I njëjti përkufizim parashihet edhe me Kodin e Etikës së Policisë, neni 22, paragrafi 2, që parasheh se kur prej zyrtarit ligjor kërkohet kryerja e detyrës që është në kundërshtim me rregulloret apo autorizimet e tij, ai është i obliguar ta refuzoj detyrën dhe të veprojnë sipas rregulloreve që rregullojnë këtë fushë, dhe se nuk mund ti imponohet kryerja e një detyre të tillë, apo ti shqiptohet ndonjë masë disiplinore ose sanksion për shkak të refuzimit të kryerjes së ndonjë akti kundërligjor.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e Major C., sipas intervistës se dhënë në raportin e përgjithshëm të hetimeve, se paditësi ka pasur për obligim vetëm rishikimin e orëve të regjistruara në raport me të, por jo edhe verifikimin e orëve të regjistruara, apo fshirjen e orëve

të regjistruara nga ai, pasi që ai është udhëheqës i paditësit, kurse për orët e regjistruara nga vet ai, paditësi nuk është përgjegjës, mirëpo këto pretendime nuk patën ndikim për vendosje ndryshe nga ajo që është vendosur, pasi që paditësi ka vepruar në kuadër të autorizimeve të tij ligjore, duke vepruar në cilësi të mbikëqyrësit, duke fshirë orët shtesë të evidentuara në mungesën e tij, kurse me asnjë provë nuk është dëshmuar se orët e regjistruara janë në përputhje me normativen ligjore, apo në kundërshtim me kërkesën e menaxhmentit me të lartë të paditurës.

Andaj, bazuar në elaborimet e lartcekura, Gjykata gjeti se Komisioni për Ankesa në vendimin e tyre, me rastin e shqiptimit të shkeljes disiplinore nga kreu III, neni 35-mosbindje e lehte, pika 1.4, në asnjë paragraf nuk e specifikon se cilat udhëzime Administrative i ka shkelur paditësi me veprimin e tij me rastin e fshirjes së orëve, po ashtu nuk ka cekur se cilat procedura të punës nuk iu ka përmbajtur paditësi, po ashtu nuk ka argumentuar bazën ligjore të procedurave të fshirjes së orëve dhe se të njëjtat duhen bërë në koordinim me mbikëqyrësin. Komisioni, në asnjë rast nuk ka pretenduar se orët e fshira nga paditësi kanë qenë orët të cilat janë regjistruar në përputhje me Udhëzimet Administrative dhe Procedurat e Punës në Policinë e Kosovës. Ndërsa marrë parasysh faktin se regjistrimi i orëve shtesë është bërë më datën 06.05.2020 kurse me datën 07.05.2020, është pranuar kërkesa për rishikim, kurse me datën 08.05.2020 është bërë fshirja e orëve shtesë, rezulton se paditësi nuk ka pasur afat kohor të raportimit të orëve për vartësit e tij, e për të cilat ka pasur mëdyshje.

Gjykata nga të gjitha provat e administruara erdhi në përfundim se e paditura nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me autorizimet të cilat derivojnë nga Ligji për Policinë dhe Udhëzimi Administrativ nr.04/2019 për Shkeljet, Masat dhe Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës lidhur me nenin 43, të Ligjit për Policinë pasi që Masa disiplinore e lartcekur, mund të shqiptohet të punësuarit sipas procedurave dhe në rrethanat e parashikuara me ligj, akte normative dhe kontratën kolektive, të cilat janë të aplikueshme në Kosovë, të cilat parashikojnë se procedurën disiplinore për shkak të shkeljeve të detyrave të punës. Kurse në rastin konkret nga provat e administruara nuk janë argumentuar shkeljet e pretenduara nga paditësi të cilat janë evidentuar në Vendimin e Komisionit për ankesa, kurse e paditura me asnjë provë nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve të paditësit në kuptim të dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, neni 319 paragrafi 1 dhe nenin 322, të LPK -së.

Andaj, nga të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim se veprimet e të paditurës Policia e Kosovës nuk kanë qenë të drejta dhe se rrjedhimisht shqiptimi i masës disiplinore me ndalës në 10 % të mjeteve nuk është vendim i drejtë dhe i ligjshëm në përputhje me dispozitat ligjore të cekura si më lartë, pavarësisht faktit se ndalesa në pagë e shqiptuar nuk është zbatuar nga e paditura andaj edhe paditësi nuk kërkoi kompensimin e dëmit material në këtë drejtim.

Gjykata në procedurë bëri shtjellimin e të gjitha provave të parashtruara nga ndërgjyqësit, kurse në arsyetimin e Aktgjykimit iu referua vetëm provave që kishin ndikim vendimtar në marrjen e vendimit si në diapozitiv.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në piken -II-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u mbështetur në dispozitat e nenit të 452 të LPK-së, pasi që i autorizuari i palës

paditëse nuk ia ka kërkuar shpenzimet e procedurës kurse pala e paditur e ka humb kontestin gjyqësor.

Andaj, nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr. 4407/2021, datë 18.10.2023.

Gjyqtarja
Rezarta Sylejmani Voca

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.